

Thirrje për shprehje interesi për pedagog Debatet studentore në universitet

Projekti: 'Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditoret universitare'

Organizata: Qendra "Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim" (SCiDEV)

Mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA)

Afati i shprehjes së interesit: 11 Nëntor 2019

Konteksti

Integrimi europian është prioriteti më strategjik i shtetit Shqiptar dhe rrjedhimisht prek thuajse të gjitha fushat, përfshi këtu edhe atë të arsimit dhe të të rinjve. Nga qershori i viti 2014, Shqipëria gëzon statusin e vendit kandidat për në BE. Megjithatë kriteret e vendosura nga Bashkimi Europian për anëtarësim janë parakushte për kalimin e fazës tjetër të procesit, i cili është ai i hapjes së negociatave, vendim i cili pritet në tetor 2019, pas përpjekjeve në qershor 2018 dhe qershor 2019. Ndërkohë që Qeveria Shqiptare dhe aktorët e tjerë politike përgatiten për procesin e hapjes së negociatave, është e rëndësishme edhe ekzistenca e një debati publik të shëndetshëm lidhur me procesin, përfitimet, kostot dhe në tërësi ndikimi që do të ketë integrimi për Shqipërinë. Arsimi dhe të rinjtë mund dhe duhet të luajnë një rol në këtë proces. Nevoja për zhvillimin cilësor të arsimit të lartë në Shqipëri është tashmë e mirëpranuar nga të gjithë aktorët. Zhvillimi i aftësive analitike dhe kritike të studentëve dhe kërkuesve të rinj është pjesë përbërëse e objektivit final për një arsim më cilësor. Kultura e debatit, etika e të debatuarit, analiza kritike, aftësitë kërkimore dhe prezantuese janë të gjithë aftësi dhe kompetenca që u nevojiten studentëve dhe kërkuesve të rinj jo vetëm në akademi por edhe përtej saj në përgatitje për tregun e punës.

Rreth projektit

Qëllimi i projektit është të përforcojë njohuritë dhe zhvillojë analizën kritike të komunitetit të studentëve e kërkuesve të rinj lidhur me Integrimin Europian dhe ndikimin shumëdimensional të tij në Shqipëri përmes organizimit të turnamentit të debatit në auditoret universitare.

Objektiva specifike:

Së pari, projekti synon promovimin e kulturës së debatit, kultivimin e analizës dhe të menduarit kritik, etikën në komunikim, tolerancën dhe vlera të qytetarisë aktive në Shqipëri tek studentët dhe kërkuesit e rinj. Së dyti, projekti synon zhvillimin e aftësive analitike të studentëve dhe kërkuesve të rinj lidhur me procesin e Integritimit Europian dhe ndikimin shumëdimensional të tij në Shqipëri.

Bazuar në rrjetin e institucioneve bashkëpunuese të “Collaborative Online and Offline Platform” (COORP), projekti synon të zbatohet në këto institucione të arsimit të lartë në fazën e parë:

1. Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (FE/UAMD)
2. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (FSHJP/UAMD)
3. Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës (FSHS/UT)
4. Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (FE/UT)
5. Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (FD/UT)
6. Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës (FHF/UT)
7. Universiteti Europian i Tiranës (UET)
8. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH)
9. Universiteti Neë York i Tiranës (UNYT)
10. Kolegji Universitar Marlin Barleti (MB)
11. Kolegji Universitar Luarasi (Luarasi)
12. Universiteti i Epokës (Epoka)

Në kuadër të zbatimit të projektit ‘Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditoret universitare’ me mbështetjen e Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), SCiDEV po kërkon të angazhojë 12 pedagogë (1 për secilin institucion të sipër përmendur) si koordinues të debateve në nivel universiteti.

Roli specifik përfshin:

- pjesëmarrje të trajnimit ToT për formatin e debatit dhe tematikat e integritit europian – dy ditë (data të mundshme 25-26 nëntor 2019);
- identifikimi i studentëve pjesëmarrës në debat (javën e parë të dhjetorit 2019);
- realizimi i debatit në nivel fakulteti/universiteti me të paktën dy skuadra – 1 ditë (brenda 28 shkurt 2020);
- pjesëmarrje në debatin final – 1 ditë (brenda mars 2020);
- ndarja e përvojës dhe sugjerime për të ardhmen (brenda mars 2020).

Kohëzgjatja e shërbimit: 15 Nëntor 2018 – 31 Mars 2020 me një total prej 8 ditë pune.

Kërkesat specifike për këtë rol:

- pedagog me interes për të punuar me studentët për zhvillimin e kulturës së debatit në fushën e integritit europian dhe ndikimin shumëdimensional në Shqipëri;
- vullnet të mirë për ta replikuar përvojën më tej në universitet në vitet e ardhshme;
- mundësi për të marrë pjesë në të gjithë aktivitetet e listuara më sipër sipas afateve të përcaktuara (shih seksionin “Roli specifik”);
- të jetë pedagog në institucionet e listuara më sipër.

Të interesuarit të shprehin interesin e tyre përmes një email dhe bashkëlidhur CV tek: info@scidevcenter.org brenda 11 nëntor 2019.